



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (2)

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 60 seminare;

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master ‘‘Përkthim teknik-letrar dhe interpretim’’

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithsme lëndore:

Moduli zhvillon te studentët aftësinë, që të zhvillojnë diskutime mbi tema komplekse, të zhvillojnë argumente dhe të mbrojnë mendimet e tyre me argumente të qëndrueshme. Të mbajnë prezantime mbi tema profesionale dhe shoqërore, t'i strukturojnë qartë dhe t'i paraqesin rrjedhshëm. Të përdorin me siguri shprehje idiomatike dhe fraza bisedore. Të kuptojnë dhe komentojnë lajme, intervista dhe fjalime. Të shkruajnë tekste të strukturuar dhe të detajuara, si p.sh. raporte, ese, kërkesa ose letra zyrtare.

Objektiva specifike lëndore:

1. Studentët mund të shprehen qartë dhe me detaje për një shumëllojshmëri temash, përfshirë edhe çështjet komplekse.
2. Ata janë në gjendje të përfshihen rrjedhshëm dhe spontanisht në biseda, të mbrojnë mendimin e tyre me argumente të qëndrueshme dhe të formulojnë kundërargumente.
3. Ata janë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të paraqesin në mënyrë të diferencuar këndvështrime të ndryshme

Rezultate të pritshme:

Moduli "Gjermanishtja si gjuhë e dytë" synon të zhvillojë më tej kompetencat dhe shprehitë gjuhësore të studentëve në përputhje me nivelin B2, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të shprehen rrjedhshëm dhe spontanisht në një shumëllojshmëri situatash të përditshme, profesionale dhe shoqërore. Në këtë modul zhvillohet më tej fjalori dhe strukturat gramatikore si dhe thellohen aftësitë komunikuese